



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
MINISTRI

Nr. 4018 Prot.

Tiranë 02. 8.2013

**U D H Ë Z I M**

Nr. 31, datë 02. 8.2013

**PËR PROCEDURAT E NDJEKJES SË ARSIMIT BAZË PËR NXËNËSIT QË NUK KANË  
NDJEKUR TË PAKTËN DY KLASA TË ARSIMIT BAZË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 5 të nenit 22 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

**KREU 1**

**TË DREJTAT E NXËNËSVE QË NUK KANË NDJEKUR TË PAKTËN DY KLASA TË  
ARSIMIT BAZË**

Gëzojnë të drejtën për të ndjekur arsimin bazë me kohë të plotë, brenda moshës së arsimit të detyruar, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Udhëzim, fëmijët që, për arsye të ndryshme,:

- a) kanë mbushur të paktën moshën tetë vjeç dhe nuk janë regjistruar në klasën e parë ose e kanë ndërprerë atë;
- b) nuk kanë përfunduar një klasë të arsimit bazë dhe nuk janë regjistruar në atë klasë në vitin pasues;
- c) kanë përfunduar një klasë të arsimit bazë dhe nuk janë regjistruar në të paktën dy vitet shkollore pasuese;
- d) janë mbetës në një klasë dhe nuk e kanë përsëritur për të paktën dy vite shkollore pasuese.

**KREU 2**

**PROCEDURAT E REGJISTRIMIT**

1. Prindi i fëmijës, që është në një nga rrethanat e parashikuara në kreun 1, i drejton kërkesën Drejtorisë Arsimore Rajonale (DAR)/ Zyrës Arsimore (ZA) ë përkatëse për regjistrimin e fëmijës.
2. DAR/ZA cakton shkollën e arsimit bazë ku fëmija do të regjistrohet.
3. Prindi, regjistron fëmijën në shkollë sipas procedurave të regjistrimit të zakonshëm të parashikuara në Dispozitat Normative.

4. Fëmija regjistrohet në klasën me grup-moshë të afërt me moshën e fëmijës ose një vit më shumë se kjo grup-moshë.

### KREU 3

#### PROCESI I MËSIMDHËNIES E I NXËNIES DHE I VLERËSIMIT

1. Drejtorja e shkollës, në bashkëpunim me mësuesin kujdestar të fëmijës, organizojnë hartimin nga mësuesit përkatës të programeve individuale të mësimdhënies dhe nxënies.
2. Në programin mësimor individual, në përgjithësi, mësuesi lëndor vendos nivelin bazë të objektivave të programit të klasës të cilën nxënësi nuk e ka ndjekur, ose përfunduar, ose është mbetës.  
Prindi i fëmijës ka të drejtë të kërkojë hartimin e një programi individual mbi nivelin bazë.
3. Mësuesi ose mësuesit e fëmijës punojnë në mënyrë të diferencuar me fëmijën brenda dhe jashtë klasës.
4. Drejtorja e shkollës, në bashkëpunim me mësuesin kujdestar, përpiqen t'i sigurojnë fëmijës ndihmë plotësuese nëpërmjet:
  - a) "mësuesve vullnetarë", që janë prindër ose persona të tjerë nga komuniteti;
  - b) bashkëpunimit me qeverinë e nxënësve;
  - c) mësuesve ndihmës.
5. Fëmija vlerësohet sipas procedurave të vlerësimit të nxënësve të klasës për të cilën po mëson.
6. Vlerësimet shënohen në regjistrin e klasës përkatëse, në një faqe të veçantë.
7. Fëmija kalon klasën, i nështrohet provimit të vjeshtës ose përsërit klasën, sipas rregullave të klasës për të cilën po mëson.


### KREU 4

#### DISPOZITA E FUNDIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe DAR/ZA-të.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit të Fletorja Zyrtare.

MINISTRI



MYQEREM TAJ

